



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 118 prot.

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 101 Datë 27.07 2022

M B I

“MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE TË CILËT PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE, (PALLATET E VALIASIT) TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.89 Datë 27.07.2022 në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Aktin Normativ nr. 09 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar; Vendim nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”; Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”; Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”; Vendimit nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së subjekteve të cilët përfitojnë nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Miratimin e subjekteve përfituese sipas listës bashkangjitur pasi plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga programi i rindërtimit të objekteve kolektive (Pallatet e Valiasit), banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas akt-ekspertizës së thelluar të Institutit të ndërtimit; (FAZA VI);
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Kamëz;
4. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë Kamëz; Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit; Drejtoria e Çështjeve Ligjore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, dhe Drejtoria e Rindërtimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi **pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

